



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr.1098 prot.

Tiranë, më 10. 06. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 165, datë 10. 06. 2026**

**PËR**  
**NDËRPRERJE TË PEZULLIMIT DHE RIÇELJE TË PROCEDURËS PËR**  
**SHQYRTIMIN E ANKESËS**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>, është regjistruar ankesa nr.174, datë 28.09.2021, e paraqitur nga znj. T.M kundër z. B.Sh , zëvendëskryetar në ish Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjinisë*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes civile*”, “*gjendjes shëndetësore*”, “*përgjegjësisë prindërore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës së sipërcituar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja T.M , me funksion në kohën e paraqitjes së ankesës Kancelare pranë ish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pretendon se është diskriminuar nga z. B.Sh , me funksion në kohën e paraqitjes së ankesës zëvendëskryetar në ish Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për shkak të “*gjinisë*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes civile*”, “*gjendjes shëndetësore*”, “*përgjegjësisë prindërore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”. Ankuesja pretendon se është diskriminuar në formën e shqetësimit, pasi ndaj saj janë ndërmarrë veprime të kundraligjshme dhe është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, pasi është grua dhe nënë beqare me një fëmijë të mitur në ngarkim. Këto sjellje kanë shkaktuar tek ankuesja pasoja shëndetësore, duke i krijuar gjendje ankthi të rënduar.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, pala ankuese kishte paraqitur ankesë kundër veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën edhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim ILD). Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua KLGJ-së me shkresën nr. 1716 prot., datë 15.12.2021 dhe ILD-së me

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtimin KMD.

shkresën nr.1717 prot., datë 15.12.2021, për të marrë informacion në lidhje me trajtimin e ankesave që ankuesja kishte paraqitur pranë këtyre dy institucioneve.

Me shkresën nr. 4393/1 prot., datë 24.12.2021, ILD ktheu përgjigje, por nuk ofroi ndonjë informacion në lidhje me shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga ankuesja pranë këtij institucioni.

Me shkresën nr.5721/1 prot., datë 29.12.2021, KLGJ ktheu përgjigje duke informuar ndër të tjera se: *“Nisur nga situata e krijuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nga raportet ndërmjet zëvendëskryetarit të gjykatës dhe kancelares në detyrë, KLGJ-ja, me urdhrin nr.138 datë 22.12.2021 ka ngritur grupin e punës për verifikimin e veprimtarisë së këshillit të kësaj gjykate, nga momenti i ushtrimit të detyrës së zëvendëskryetarit nga ana e z. B.Sh . Grupi i punës do të verifikojë procedurat e ndjekura për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, plotësimin të vendeve vakante në shërbimin civil gjyqësor në këtë gjykatë si dhe çdo vendimarrje tjetër të tij gjatë kësaj periudhe. Në përfundim të verifikimeve, KLGJ do ju bëjë me dije mbi rezultatet e verifikimit të veprimtarisë administrative të Këshillit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.”*

Në bazë të nenit 33/9, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në datën 20.01.2022, u zhvillua një seancë dëgjimore. Në seancë morën pjesë ankuesja T.M dhe përfaqësuesja e saj Av. K.S, me Licence nr.1579. Nuk u paraqit z. B.Sh , i cili njoftoi se ishte në pamundësi për të marrë pjesë në seancë dhe do të depozitonte në vijim informacionin në lidhje me seancën dëgjimore. Ndër të tjera, gjatë seancës dëgjimore, ankuesja deklaroi se në dijeninë e saj edhe ILD kishte filluar një procedurë hetimore ndaj z.B.Sh , por shkresën për fillimin e kësaj procedure nuk e dispononte.

Në këto kushte, kur KLGJ-ja kishte filluar një procedurë verifikuese në lidhje me ligjshmërinë e veprimtarisë së z.B.Sh , si Zëvendëskryetar i ish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, që nga momenti i fillimit të ushtrimit të kësaj detyre, Komisioneri vlerësoi se, rezultatet e verifikimit që do të kryheshin nga KLGJ-ja, si organi i qeverisjes së sistemit gjyqësor, përbënin një informacion të nevojshëm për shqyrtimin e mëtejshëm të pretendimeve të ngritura në ankesë.

Me vendimin nr.58, datë 23.03.2022, Komisioneri, vendosi pezullimin e procedurës administrative lidhur me shqyrtimin e kësaj ankese, deri në sigurimin e informacionit në lidhje me rezultatet e verifikimit nga KLGJ.

Me shkresën nr.1212 prot., datë 08.09.2022, Komisioneri ka kërkuar informacion nga KLGJ, nëse kishin përfunduar verifikimet dhe nëse po, të vendoseshin në dispozicion të Komisionerit rezultatet dhe përfundimet e arritura. Me shkresën nr.5721/4 prot., datë 21.09.2022, KLGJ ka informuar se procesi ende nuk kishte përfunduar.

Me shkresën nr. 514 prot., datë 06.03.2026, Komisioneri i është drejtuar KLGJ me kërkesë për informacion nëse ka përfunduar procesi i verifikimit.

Me shkresën 1535/2 prot., datë 15.05.2026<sup>3</sup>, KLGJ ka informuar Komisionerin se:

*“Bazuar në kërkesën e znj.T.M , kundër z.B.Sh , Zevendëskryetar në ish Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes familjare, gjendjes civile, gjendjes shëndetësore, përgjegjësisë prindërore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me*

<sup>3</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 514/1 prot., datë 19.05.2026.

*vendimin nr.228, datë 23.04.2025, kërkues, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, subjekt i procedimit magjistrati z.B.Sh , objekti, fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit B.Sh me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ( në kohën e fillimit të procedimit), ka vendosur:*

*Pranimin e kërkesës së Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistratit z. B.Sh , me funksion gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.”*

Vendimi nr. 228, datë 23.04.2025, i KLGJ-së, i cili ka caktuar masën “Vërejtje publike” ndaj magjistratit z. B.Sh , vërteton se procesi i verifikimit ka përfunduar dhe rezultatet janë bërë të njohura. Si rrjedhojë, shkaku për të cilin procedura administrative u pezullua, bazuar në vendimin nr. 58, datë 23.03.2022, të Komisionerit nuk ekziston më. Në këto kushte, Komisioneri çmon se, duhet të vendoset ndërprerja e pezullimit dhe riçelja e procedurës së shqyrtimit të ankesës.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 85, pika 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Ndërprejten e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 58, datë 23.03.2022 dhe riçeljen e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr.174, datë 28.09.2021.
2. Të njoftohen për këtë vendim palët, ankuesja znj. T.M dhe z. B.Sh .
3. Ky vendim i dërgohet për dijëni Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**

Shkaku: *gjinia, gjendja familjare, gjendja civile, gjendja shëndetësore, përgjegjësia prindërore, “çdo shkak tjetër”.*  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Ndërprerje pezullimi\_riçelje e procedurës